



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/K1-7 Prot.
Nr. Dok. 202502283/7

Tiranë 18/12/2025

Lënda: Rekomandim për ekzekutimin e vendimit nr.*** (**-****-****), datë 23.11.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit, ku vendoset se shtetasi A.B duhet të vazhdojë masën mjekësore "mjekim i detyruar spitalor", duke urdhëruar kurimin e tij në një institucion mjekësor psikiatrik

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Komitetit Kombëtar për Shëndetin Mendor

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER

Për dijeni: **MINISTRISË SË DREJTËSISË**
Komisionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM FIER

Të nderuar,

Në institucionin e Avokatit të Popullit është administruar ankesa e shtetasit K.B për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor *** (**-****-****), datë 23.11.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit, lidhur me vendosjen e vëllai të tij, shtetasit A.B në një institucion mjekësor psikiatrik.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Aktualisht, shtetasi A.B gjendet i shtruar në IEVP Lezhë, pavarësisht se ndaj tij është dhënë masa mjekësore e “mjekimit të detyruar në një institucion mjekësor psikiatrik”, ndërkohë që para kësaj periudhe ai ka qëndruar edhe në Institucionin e Veçantë Krujë (Zahari) dhe Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve. Sikurse, vërtetohet këto institucione janë pjesë e sistemit penitenciar dhe jo një institucion mjekësor psikiatrik.

Shtetasi A.B ka qenë i diagnostikuar me skizofreni në vitin 1976 si pasojë e një dëmtimi në kantierin e ndërtimit dhe me vendimin nr.61, datë 08.02.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është vendosur: *“Pushimi i gjyqësor të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A.B, i akuzuar për veprën penale të vrasjes në tentativë si rezultat i papërgjegjshmërisë për shkak të gjendjes mendore të të pandehurit. Shtrimin e të pandehurit A.B për mjekim të detyrueshëm në spitalin psikiatrik në Tiranë, duke marrë masa për ruajtjen e tij.”*

Prej vitit 2001 e në vijim ky shtetas vijon të mbahet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, pavarësisht se ndaj tij nuk rezulton të jetë dhënë asnjë vendim gjyqësor që ta deklarojë këtë shtetas fajtor për kryerjen e ndonjë veprë penale dhe ta ketë dënuar me burgim.

Midis tyre, shtetasi K.B vëllai dhe njëkohësisht kujdestari ligjor i A.B iu është drejtuar disa institucioneve shtetërore, atyre të pavarura dhe gjykatës për zgjidhjen e çështjes së qëndrimit dhe trajtimit të vëllait të tij.

Kështu, ai i është drejtuar Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe më pas Gjykatës së Apelit.

Avokati i Popullit ka trajtuar në vite ankesat e shtetasit K.B, duke adresuar edhe rekomandimet përkatëse për këtë rast. Me shkresën nr.K2/K4-5 prot., datë 27.02.2018 i ka rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë marrjen e masave **për ngritjen sa më shpejtë të institucionit spitalor psikiatrik të specializuar** për të sëmurët mendorë me masë mjekësore mbyllje e detyruar në spitalin psikiatrik, sipas kërkesave të nenit 46 të Kodit Penal dhe të nenit 28 të ligjit nr.44/2012 *“Për shëndetin mendor”*.

Ndërkohë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me vendimin nr.255, datë 19.12.2018 ka vendosur:

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe të “aftësisë së kufizuar” të shtetasit A.B dhe të gjithë kategorisë të të sëmurëve të shëndetit mendor të ndodhur në të njëjtat apo në kushte të ngjashme me të, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Në referim të pikës 1, MSHMS në bashkëpunimin e Ministrisë së Drejtësisë, deri në ngritjen e një institucioni të posaçëm:

- Të marrë të gjitha masat e nevojshme për përshtatjen e ambienteve të IVSH Tiranë dhe dy godinave 4 dhe 5 në IEVP Lezhë për akomodimin e shtetasve me vendim gjykatë me masë mjekësore “Shtim i detyruar në një institucion psikiatrik”, si një institucion i posaçëm mjekësor.
- Ta pajisë atë me të gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe të domosdoshme mjekësore dhe personelin e specializuar mjekësor dhe psiko-social.
- Godinat të kalojnë tërësisht nën administrimin dhe kujdesin e MSHMS, sikurse parashikohet në ligjin nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”.
- 3. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, MSHMS, të njoftojë Komisionerin lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
- 4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
- 5. Rekomandohet Prokuroria e Përgjithshme të udhëzojë në mënyrë të qartë të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda, si dhe pranë gjykatave të apelit, për zbatimin në mënyrë korrekte të ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht, për zbatimin në mënyrë të ligjshme të vendimeve të gjykatës me masën mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion psikiatrik”.

Shtetasi K.B, në cilësinë e kujdestarit ligjor të shtetasit A.B, i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, **me palë të paditura:** Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë, **me objekt:** “Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, detyrimin e palëve të paditura për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sjellja diskriminuese, zbatimit të menjëhershëm të masës mjekësore në një institucion mjekësor psikiatrik etj.” Kjo gjykatë me vendimin nr.*** (**-****-***), datë 09.03.2020, ka vendosur:

- Pranimin e pjesshëm të padisë.
- Detyrimin e palëve të paditura Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institutit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Zahari Krujë, që t’i paguajnë paditësit A.B dëmin jopasuror (dëmin biologjik+dëmin moral+dëmin ekzistencial) në shumën totale 3.670.390 lekë dhe paditësit K.B dëmin jopasuror (dëmin moral+dëmin ekzistencial) në shumën totale 1.835.195 lekë.
- Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera të saj.
- Rrëzimin e padisë për palët e paditura Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për mungesë të legjitimitetit pasiv.

Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, pala paditëse A.B dhe K.B ku kanë kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e plotë të padisë.

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr.*** (**-****-****), datë 23.11.2023, ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr.***, datë 09.03.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Pranimin pjesërisht të padisë.
- Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të paditësit A.B nga të paditurit për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe “mohimit të një përshtatje të arsyeshme”, si rrjedhojë e aftësisë së kufizuar të shtetasit A.B.
- Detyrimin e palëve të paditura solidarisht për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sjellja diskriminuese, përmes ndreqjes së shkeljeve ligjore dhe pasojave nëpërmjet:
- **-Zbatimit të menjëhershëm të masës mjekësore në një institucion mjekësor psikiatrik për shtetasin A.B.**
- Shpërblimit të dëmit jopasuror në masën 3.670.390 lekë për paditësin A.B dhe në masën 1.835.195 lek për paditësin K.B.
- Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërtimeve në padi.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, me ligjin nr.108/2012 *“Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”*”, vendi ynë ka ratifikuar këtë Konventë të miratuar më 13 dhjetor 2006, qëllimi i së cilës është të promovojë, të mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të lindur.

Nëpërmjet ratifikimit të saj, Shqipëria siguron aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar në kushte të barabarta me të tjerët në mënyrë të tillë që ata të mund të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës.

Neni 46/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se kur gjendja mendore e të pandehurit tregon se ai duhet të kurohet, gjykata vendos edhe kryesisht shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik. Kur është vendosur ose duhet vendosur masa mjekësore e detyrueshme për të pandehurin, gjykata urdhëron që i pandehuri të ruhet në një institucion psikiatrik. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori i kërkon gjykatës të vendosë për shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik dhe kur vonesa paraqet rrezik, urdhëron shtrimin e përkohshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

Neni 45 i ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”*, përcakton në mënyrë taksative se masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet në institucionin mjekësor të specializuar sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e prokurorit. Në harmoni me këtë nen vjen edhe neni 56 i ligjit nr.79/2020 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”* ku parashikohet: *“Për personin e papërgjegjshëm që ka kryer një vepër penale, masa mjekësore me mjekim të detyruara ekzekutohet sipas vendimit të gjykatës në institucionin mjekësor të specializuar të përcaktuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.”*

Në rastin e A.B është dhënë mjekim i detyruar në një institucion psikiatrik, por nga rrethanat e faktit ka rezultuar **se kjo masë është zbatuar në vendin e qëndrimit IEVP Krujë dhe IEVP Lezhë, pra jo në vendin e përcaktuar me vendim gjykatë.**

Sipas nenit 5 të ligjit nr.44/2012 *“Për shëndetin mendor”* personat me çrregullime mendore, duke përfshirë edhe personat e papërgjegjshëm penalisht trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor. Është detyrë e autoriteteve që t’iu ofrohet kujdes në një mjedis sa më pak shtrëngues nga ekipe multidisiplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit.

Shtetasi A.B me masë mjekësore “mjekim i detyruar” është vendosur dhe mbahet në mënyrë të paligjshme në institucionet penitenciare dhe jo në një spital psikiatrik.

Pavarësisht dispozitivit të qartë të këtij vendimi gjyqësor, ai mbetet i paekzekutuar sa i përket detyrimit për *“zbatimin e menjëhershëm të masës mjekësore në një institucion mjekësor psikiatrik për shtetasin A.B.”*, duke bërë që ai të vijojë të qëndrojë në IEVP Lezhë.

Nga ana e saj, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka kryer rivlerësimin e masës mjekësore të vendosur me vendim nr.***, datë 08.02.2001 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me vendimin nr.**-****-**** (***), datë 07.05.2025 ka vendosur: *“Vijimin e zbatimit ndaj shtetasit A.B të masës mjekësore të “mjekimit të detyruar në një institucion mjekësor” të parashikuar nga neni 46 i Kodit Penal.”*

Urdhërohet që shtetasi A.B, të vijojë trajtimin në një institucion psikiatrik (institucion mjekësor i posaçëm) sipas përcaktimeve të ligjit nr.79/2020 dhe ligjit nr.81/2020.

Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Prokuroria ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit për këtë vendim dhe shtetasi A.B vijon të qëndrojë në IEVP Lezhë.

II. Konstatimet dhe vlerësimi i Avokatit të Popullit

Sikurse e theksuam, kjo çështje është trajtuar nga institucioni i Avokatit të Popullit, duke adresuar edhe rekomandimet përkatëse. Ngritja sa më shpejtë e institucionit spitalor psikiatrik të specializuar për të sëmurët mendorë me masë mjekësore mbyllje e detyruar në spitalin psikiatrik, sipas kërkesave të nenit 46 të Kodit Penal dhe të nenit 28 të ligjit nr.44/2012 *“Për shëndetin mendor”* mbetet një çështje ende e pazgjidhur, pavarësisht ndjeshmërisë së lartë për trajtimin e kësaj kategorie.

Që nga momenti i caktimit të masës mjekësore shtrim i detyruar në një institucion psikiatrik dhe marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor që ka caktuar këtë masë më datë 08.02.2001, **z.A.B vijon të mbahet në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale**, që janë pjesë e sistemit penitenciar, **24 vjet**. Nga gjykata është konstatuar se, **shëndeti i tij si fizik ashtu edhe mendor, është përkeqësuar**.

Kujdestari i tij ligjor iu është drejtuar institucioneve kompetente, që të merreshin masat e menjëhershme për vendosjen e tij në një institucion psikiatrik, por situata mbetet pa një zgjidhje dhe është peng i proceseve të vazhduara gjyqësore.

Lidhur me sa parashtroam më lart, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se vendimi i gjykatës duhet të zbatohet në përputhje me kushtet dhe infrastrukturën në të cilën ndodhet sistemi penitenciar dhe ai shëndetësor në vendin tonë, por gjithashtu edhe me gjendjen e shëndetit fizik e mendor të shtetasit A.B.

Në nenin 18 të Kushtetutës përcaktohet:

- “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.*
- 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlijje e arsyeshme dhe objektive.*

Po ashtu, në nenin 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut parashikohet:

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

Qëndrimi ynë institucional lidhur me çështjen e trajtimit të shtetasve që i përkasin këtij target grupi, është dhënë në disa rekomandime¹ drejtuar: Ministrisë të Drejtësisë, Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Ligji nr.88/2020, pika 2, neni 15 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”* dhe ligji nr.44/2012 *“Për Shëndetin Mendor”*, konkretisht, në nenin 28, pika 22 të këtij ligji, kanë përcaktuar qartë se, trajtimi shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht veprës penale që kanë kryer dhe për të cilët gjykata kompetente ka vendosur masën “mjekim i detyruar” apo “shtrim i detyruar”, duhet të kryhet në një Institucion të Posaçëm Mjekësor, pjesë e sistemit shëndetësor të integruar, dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar.

¹ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20Lezhe%202024.pdf>

Mbyllja e të dënuarve me probleme të shëndetit mendor në institucione të veçanta brenda sistemit penitenciar, **përbën dhunim të rëndë të të drejtave të tyre**, për këtë qëllim e vlerësojmë të rëndësishëm faktin që IEVP Lezhë konsiderohet “institucion tranzitor”, deri në konkretizimin e hapave për ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor.

Ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit *“Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore”* më datë 23.11.2021.

Kjo marrëveshje ka përcaktuar përgjegjësitë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në lidhje me pacientët e mbajtur në ambientin e përkohshëm si: ofrimi i shërbimeve të specializuara të mbështetjes psikiatrike, diagnostifikimi dhe ekzaminimet laboratorike.

Marrëveshja e bashkëpunimit e vitit 2021 thekson shprehimisht se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për ndërtimin, planifikimin dhe menaxhimin e Institucionit Mjekësor të Posaçëm të ardhshëm. Ndërkohë, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për administrimin dhe sigurinë e objektit të përkohshëm.

Avokati i Popullit, ndër të tjera, ka rekomanduar shprehimisht: - *“Marrjen e masave për planifikimin e ngritjes dhe funksionimit të Institucionit Mjekësor të posaçëm, si strukturë e posaçme për ofrimin e një kujdesi terapeutik, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, si dhe informimin e institucionit tonë në lidhje me Planin e Veprimit të përbashkët për trajtimin e personave me masë mjekësore, për detajimin e aktiviteteve specifike me afate kohore konkrete, sipas angazhimeve të marra në marrëveshjen e përbashkët, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.*

Sa rezulton, në vijimësi kemi theksuar se, personat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht veprës penale që kanë kryer dhe për të cilët gjykata ka vendosur masën “mjekim i detyruar” apo “shtrim i detyruar”, duhet të trajtohen në një institucion të posaçëm mjekësor, pjesë e sistemit shëndetësor dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar. Kjo do të ishte zgjidhja e përshtatshme për ofrimin e shërbimit të nevojshëm shëndetësor ndaj këtyre personave, në mënyrë që t’u ofrohen programe gjithëpërfshirëse të vlerësimit, trajtimit dhe rehabilitimit të tyre.

Po ashtu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Vendimin nr.255, datë 19.12.2018, e ka konsideruar trajtim diskriminues mbajtjen në IEVP të personave që i përkasin kategorisë të sëmurëve të shëndetit mendor dhe i ka rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të marrë masa sa më parë për ngritjen e një institucioni të përshtatshëm për këta persona.

Sa më sipër, konstatohet se Gjykata Administrative e Apelit me vendimin e saj nr.912 (86-2023-1248), datë 23.11.2023, e ka trajtuar po njësoj këtë çështje, duke vënë theksin te

KEDNJ, rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe vendimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nga ana tjetër, mosvënja në zbatim e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier sipas përcaktimeve të tij në dispozitiv, vjen në kundërshtim me disa akte normative dhe konkretisht:

1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 142/3, ku parashikohet se: *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*.
2. Kodi i Procedurës Penale, respektivisht nenet 24/1², 462/1³, 463/1⁴ dhe 464⁵, ku parashikohen detyrimet e prokurorit për të vënë në ekzekutim vendimin penal të gjykatës pasi të ketë marrë formë të prerë.
3. Ligjin nr.79/2020 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”*, respektivisht nenet 8⁶; 11/1⁷; 23/4/5⁸ dhe neni 56⁹, ku parashikohet detyrimi i prokurorit për të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e këtij ligji.

² Në nenin 24/1 të Kodit të procedurës Penale parashikohet se:

Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, **merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre**, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

³ Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë.

⁴ Prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, merr masa për ekzekutimin e vendimit. Ai bën kërkesa në gjykatën kompetente dhe ndërhyr në të gjitha veprimet e ekzekutimit.

⁵ Në nenin 464 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:

1. Për ekzekutimin e një vendimi me burgim, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit.
2. Urdhri i ekzekutimit përmban gjeneralitetet e të dënuarit, dispozitivin e vendimit dhe disponimet e nevojshme për ekzekutimin.
3. Kur i dënuari është i paraburgosur, urdhri i dërgohet organit shtetëror që administron burgjet dhe i njoftohet të interesuarit, ndërsa kur i dënuari nuk është i paraburgosur urdhërohet burgimi i tij.
4. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për rastet e ekzekutimit të vendimeve të mbylljes së detyrueshme në institucione mjekësore ose edukimi.

⁶ Prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit penal në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e këtij ligji, si dhe të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit. Në rast të konstatimit të parregullsive, prokurori ka të drejtë t'i kërkojë organit përgjegjës ose gjykatës rivendosjen e të drejtës së shkelur, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës.

⁷ Prokurori merr masa dhe vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal dhe, në mbështetje të neneve 463 dhe 468 të Kodit të Procedurës Penale, procedon vetë ose urdhëron organet e tjera për vënien në ekzekutim të vendimit, sipas këtij ligji.

⁸ 4. Mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe kriterëve të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, prokurori përcakton llojin e institucionit ku i dënuari do të kryejë dënimin dhe në konsultim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve përcakton institucionin konkret.

5. Kur gjykata nuk e ka konstatuar dhe prokurori ka të dhëna se është vendi për vendosjen në institucione mjekësore të posaçme, ai urdhëron kontrollin mjekësor të të dënuarit dhe, kur ka arsye, në bazë të rezultateve, i paraqet kërkesë gjykatës sipas parashikimeve ligjore.

⁹ Në nenin 56 të Ligjit Nr. 79/2020 parashikohet se:

1. Për personin e papërgjegjshëm që ka kryer një veprë penale, masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet sipas vendimit të gjykatës në institucionin mjekësor të specializuar të përcaktuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.
2. Me urdhrin e ekzekutimit të prokurorit, dërgimi në institucionin mjekësor i personit që dyshohet se ka kryer një veprë penale kryhet: a) nga institucioni mjekësor që e ka në trajtim; b) nga institucioni mjekësor me ndihmën e Policisë së Shtetit, kur kërkohet nga mjekët që e kanë në trajtim; c) nga Policia e Shtetit në rast se i dyshuari i lirë nuk ekzekuton urdhrin vullnetarisht.

Neni 4 i ligjit nr.44/2012 *“Për shëndetin mendor”* sanksionon se *“Mbrotja dhe promovimi i shëndetit mendor kryhen nëpërmjet masave që kontribuojnë në sigurimin ose rivendosjen e ekuilibrit mendor të individit, duke fuqizuar kapacitetet individuale, duke promovuar integritetin, duke përmirësuar pranimin dhe duke luftuar diskriminimin e stigmën në mjedisin social të tij”*.

Gjithashtu, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga vendimi i çështjes Strazimiri kundër Shqipërisë (aplikimi nr.34602/16), datë 21.10.2010 të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, shtetit shqiptar i lihet detyrë që të krijojë *“institucion të përshtatshëm”* ose të ndërtojë një mjedis të ri të specializuar për strehimin e personave për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara siç është në rastin konkret A.B.

Në këndvështrim të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, organet publike kanë detyrimin për të minimizuar rreziqet që i kanosen jetës/shëndetit të individit, nëpërmjet marrjes së masave të përshtatshme legjislative, administrative dhe operacionale.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në funksion të detyrës funksionale, sipas ligjit, për ekzekutimin e vendimeve penale është e detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit sipas urdhërimeve të gjykatës.

Sipas nenit 56 të ligjit nr.79/2020 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”* ku parashikohet: *“Për personin e papërgjegjshëm që ka kryer një vepër penale, masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet sipas vendimit të gjykatës në institucionin mjekësor të specializuar të përcaktuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë”*.

Një nga masat që kontribuojnë në sigurimin ose rivendosjen e ekuilibrit mendor të këtyre individëve, shprehet në parimin e përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 5 të këtij ligji, ku thuhet se: *“kujdesi shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor, ofrohet në një mjedis sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjet nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social.”*

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së*

3. Masa mjekësore me mjekim të detyruar ambulator ekzekutohet në institucionet mjekësore të vendbanimit të të detyruarit. Kur në to nuk ka specialistë përkatës, shoqërohet në çdo rast nga këto institucione në rrethin më të afërt ku ka të tillë.

4. Kur gjatë ekzekutimit të kësaj mase sillen pengesa nga i detyruari, prokurori urdhëron ekzekutimin e detyruar nga Policia e Shtetit dhe, kur është vendi, i paraqet kërkesë gjykatës për ndryshimin e masës në mjekim të detyruar në një institucion mjekësor të specializuar.

shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”.

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për ekzekutimin e vendimit nr. *** (**-*****-***), datë 23.11.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit, ku është vendosur se shtetasi A.B duhet të vijoje masën mjekësore “mjekim i detyruar spitalor”, duke urdhëruar kurimin e tij në një institucion mjekësor psikiatrik (jashtë sistemit të IEVP-ve).

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Besnik DEDA

D.V